




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/39 datë: 31.01.2024

Bazuar në nenin 12.2. pika (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Si dhe duke u bazuar në nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 31.01.2024 moratoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
DRAFT-PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2024-2028

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 31.01.2024, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin e veprimit për transparencë komunale për periudhën 2024-2028. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi